

Një normë model e psikanalizës në prozë

Nga **FATMIR TERZIU**

Romani "Kloroform" i autores, Klara Buda, është një metamorfozë e qetë psikologjike e jetës. Më qartë, është një protestë shpirtërore që tejzgjatet në mënyrë filozofike mes tolerancës dhe faljes, vrytë dhe moralit, fatit dhe jetës. Është një prozë që udhëton vite pas për të ndërtuar fatin e privuar dhe të ndëshkuar të individit në diktaturë, jo thjesht si një fabul, por si një dëshmi e padiskutueshme për kohërat. Romani është edhe një vështrim femëror mbi botën shqiptare, atëkohë maçiste, falë syve modernë por jo feministë. Këtu do të shkonte mrekullisht ajo që Oscar Wilde ka deklaruar tek romani i tij "Admiruesi i Zonjës Windermere" (Lady Windermere's Fan). Dhe pikërisht ai deklaroi se "mjaf femra kanë të shkuarën e tyre, por unë jam i vendosur se ajo me këtë të shkuar na paraqet një duzinë mendimesh, dhe se ato të gjitha janë të arsyeshme". Kështu bën në fakt edhe Buda në romanin e saj të parë.

Gjuha dhe karakteret, identitetet si shkas


Është një promemorie e shkruar ndjeshëm dhe rrjedhshëm sa fjalët e dhimbshme e vendosin në vëshirësi vetë tolerancën, faljen, vrytëtin dhe moralin. "Kloroform" përzgjedh të pathënën deri më sot në një mënyrë të tillë prozaike për atë gjysmëshekull mizor nga vështrimi i një femre krijuese për vetë fatin për vërsniket e saj. Dhe natyrshëm këta vërsnikë me fat të ngjirë në morgun e komunizmit edhe pse kanë një emër me identitet të dyzuar në roman, kanë një fat të trishtë, një jetë të ngushtëzuar, një fat të privuar. Na vijjnë ngadalë risqe jetike që kapërcehen nën emrin e Alma Fishtës dhe na shkulen pjesë trupore nga dhimbja në identitetin e remë që vjen si një asfiksë e jetës nën kloroform, diku me emrin Luiza Kodra për Alma Fishta. Një paralele kjo që gjendet në mjeshtrinë e Remarkut të papërsëritshëm, kur vuri numrat e nazizmit në kujtesë të ngjashme me prozën e "Kloroform". Identitete të reme! Identitete që fshiheshin nën emra Marenglen Qani Qeni, nën trupa-bust maskullorë që kryenin të njëjtin veprim paralel historik ndaj fatit të njeriut femër si në kohën e nazizmit. I vetmi ndryshim vrasës mes dy këtyre fateve historike ndihet nën zhourm të ndryshme vrasëse. Për të parin ishin krematoriumet dhe për të dytin ato bodrume të gjata e të lagështa, të errëta ku jeta vritej që në embrion.

"Morgu ishte një sallë e gjatë ku muret, tavani dhe gjithçka që ndodhej brenda saj, ashtu si paradhoma, qenë llyer me bojë vaji gri të çelur", shkruan Buda. Në këtë pikë "Kloroform", dikton më shumë kujdes. Një kujdes që bëhet thirrje e brendshme e ndërgjegjës, që bëhet strukturë e dhimbjes. Ngjyra gri boshatiset gradualisht dhe shfaqet ngjyra rozë e qelqë, si një simbolikë me trekëndëshin e baxhes, trekëndëshin rose te kampeve naziste... Në këtë përgjegjësi, po aq edhe në simbolikën e një emri të krijuar bukur Marenglen Qani Qeni, vdekja dhe morgu marrin një kuptim tjetër në roman. Raporti i vdekjes vjen në një raport të ndjeshëm me ngjyrat. E kuaja e sfiduar me pak të bardhë, që formon rozën e preferuar të përgjegjësit, nuanca bezhë e mishit të pajetë të kadvrave dhe ftohtësia e hirtë e mureve janë një mishërim i asaj diplome që varej në murin e morgut, një diplomë që liçensonte vdekjen e asaj salle me emrin morg. Edhe pse një punë e helmuar mbetej kësaj dhe dhuruar për tipin e Marenglen

Qani Qeni, pasi ai dhe drejtori kishin të drejtën e hapjes dhe mbylljes së morgut. Një punë socialiste, që dukej ndryshe nga të tjerat, që dallonte nga dekoratrat e mara pas vdekjes, një morg që ndodhet fizikisht disi larg nga ministrinë, por që gatuan çorbën e tyre me jetën, një bulevard "Stalin" që shihet qartë nga klinika, një jetë rinore që gatuhet në një Universitet ku gjallojnë mendimet rinore, një mori karakteresh që sjellin progresin si kundërvëniet të regresives, diktatura që kërkon në tërë këtë amorfitet jetik armikun e jashtëm nga sinjalët ajrorë, njeriu i ri që gatuhet me urdhër nga lart, arti që prodhon humor, dashuria e sfumuar nga transplantimi i himenit, mbesin disa nga shtysat për të lexuar ngeshëm romanin, e që në rrefimin e Budës vjen me distancën epike të rrefimit.

Distanca epike e rrefimit

Duke udhëtuar me frymëdhjatje të shtrënguar mes emocioneve që të përkthehen herë në lotë e herë në inat njerëzor, mes faqeve të romanit natyrshëm e ndjen edhe distancën epike të rrefimit. Buda e shoqëron këtë distancë me një kërshëri të bollshme njohurish që vijjnë në formën jolineare të ndodhisë, për të ngushtuar ndjeshëm hapësirën dhe vitet që i përkasin më së shumti periudhës 1970-të. Këtu autorja shfaqet në funksion të dyfishtë. Ajo shfaqet e qetë në rolin e narratorit neutral dhe të papërzier që tregon mjeshtërisht ngjarjet e romanit. Dhe këtu ridimensionohet rrëfjenja e saj pasi gjendet në rolin e tregimtarit, ku pozicioni i saj është paksa më i tërhequr, sepse nga koha kur kanë ndodhur ngjarjet e deri në çastin që ajo i detajon artistikisht thaujse ka kaluar një periudhë e barabartë gati me moshën e saj. Ajo me këtë ndërhyrje tipike e të arritur synon dhe realizon bukur të rrefejë në mënyrë objektive, por pa shfaqur emocionet e veta, pa u ndikuar nga toleranca, falja, vrytëti, vesi, fati dhe jeta, si aspekte të filozofisë së aplikuar në tërësinë e ngjarjeve. Në disa episode, pikërisht kur autorja kërkon të ngushtojë distancën epike të rrefimit ajo shpesh bie në një pozicion subjektiv, por që anashkalohej nga ndërhyrjet e saj të holla, të bazuara në folk-traditën vargore shqiptare në lidhje me këtë temë. Duke përdorur këtë linjë dhe duke dhënë më shumë të dhëna edhe për ndodhi jashtë ngjarjes, Buda realizon me art-vlërën e mesazhit të kombinuar dhe tejkalon hapësirën lodhëse në prozë. Kësaj romani mбетet tërheqës edhe përpos distancës epike të rrefimit. Vënia e epilogut në disa raste e karakterizon këtë distancë dhe e fuqizon arsyen për ta lexuar dhe parathënë arritjen e autores. Këtu ajo shfaqet si një person në veprim, e detajuar në mënyrë të tërthortë dhe realizuar me cilësi psikologjike. Ajo ndërthur cilësitë e veçanta me cilësitë e përgjithshme. Kështu me plot gojë mund të themi se Klara Buda, përbën karakter letrar të qëndrueshëm, prekës, domethënëse, që pa as më të voglën dyshim mund të jetë ushqim i një filmi artistik me metrazh të gjatë, ku rolin jetik e merr jo vetëm koha dhe fati jetik i individit në Shqipërinë totalitare, por më gjerë,



Romanin "Kloroform" mund ta gjeni ne adresën

<http://www.shtepiaelibrit.com/libri/>

pra mbetet dhe është vepër globale. Ajo me një stil të ndjeshëm ka gjetur heroin e veprës dhe me të ka gatuar fabulën, pa e lodhur lexuesin dhe kritikun e saj.

Duke udhërrëfyer karakterin kryesor

Heroin kryesor i romanit, edhe pse një femër, të cilën e njohim nga kornizat e saj krijuese, jo vetëm nga ligjësitë letrare, ndryshon në thelb, jo vetëm sipas modulit të letërsisë, nga një hapësirë në një tjetër, por nga mesazhi, emocioni dhe vetë fabula që e rrethon dhe e shoqëron deri në fund. Teorikisht, Alma Fishta, është një lidhje e detajuar e pjesëve të veçanta të romanit, duke kryer edhe fuqizimin e motiveve dhe njësive të tjera të fabulës që ka prurë fuqimisht në mesin e letërsisë shqiptare një autore si Klara Buda, me formim perëndimor. Fuqizimi i njësive të tjera të fabulës Ky roman ka një linjë të prekshme në fuqizimin e njësive të tjera të fabulës. Kryhen në mënyrë të strukturuar grupimi i ngjarjeve, raporti dhe lidhjet e tyre në mënyrë që të qartësohet natyra e veprimit të Alma Fishtës, e cila na jepet e goditur në këtë mes dhe një pjesë e motiveve e shquajnë atë nga grumbulli i personazheve të tjera që theksojnë rolin e saj në zhvillimin e ngjarjeve. Po të kemi parasysh novelën "Natë me hënë" të shkrimtarit Ismail Kadare, ku personazhit të kësaj novele, Marisë, i kërkohet çertifikata e virgjërisë për ta shkatërruar atë moralisht, edhe pse që në fillim të leximit na shfaqet e qartë figura virgjërore e saj, natyrshëm kuptojmë më qartë edhe misionin e autores. Por në romanin e Budës, ky element vjen i ndërthurur me jetën që prodhon femra si nënë. Pra, më afër psikoanalizës.

Çështja e fatit të femrës ka qenë vendimtare në historinë e psikoanalizës, edhe pse fati i saj ka qenë i trazuar. Steven Marchus tek hyrja e përshkrimi për librin e Frojdit, e quan diskutimin e tillë për elementin femër pas cilësimit të Frojdit një "tragjikomedij" në fjalë (1975:XXXVIII). Por

në fakt askush nuk del se ishte më i përkushtuar rreth subjektit në fjalë se sa Frojdi. Disa gjejnë shprehjen e pasigurisë së tij nga shkrimi i tij i parë me temë rreth femrës dhe seksualitetit, më qartë nga deklarata e tij tek statementi i "Tre eseve për teorinë e seksualitetit" (1995). Ata gjykojnë dhe argumentojnë në mënyrë akademike rreth këtij fati të çliruar kohë më parë teorikisht nga teoria e psikanalizës së Frojdit. Ndërsa në letërsinë shqiptare këtë e ndeshim në forma të ndrydhura. Elementi prozaik bashkëkohor i Budës, bën që ky ridimensionim psikoanalitik të depërtojë rishtaz si një koherencë kohore. Çështja e fatit të femrës, edhe pse e vëzhguar artistikisht në diktaturën komuniste, vjen si në një pasqyrë normative për të parë e analizuar qartë.

Lidhja me jetën: një jetë brenda jetës së nënës

Nuk është thjesht një bisedë e protagonistes, Alma me karakterin Maksi, që rrjedh mes çajit të trëndafillet të egër me doza ideale thartie, që mikset me "infuzionin" Rosa Canina që pritet me konjak "Skënderbeu", dhe kur mungon me fernet, por një bisedë që zbulon një pjesë të fabulës për 'moralin komunist', në lidhje me mbajtjen e një fëmijë nga një marëdhënie me një të zhdukur nga azili psikiatrik. Është fjala e zgjimit të fabulës në një shtrat ku synon të flejë një jetë brenda jetës së nënës, një dualitet që riskon këtë jetë për shumë arsye të asaj kohe. Dhe në këtë dialog rishfaqet situata që sqaron botën e studentëve të degës së Veterinarisë, që janë në thelb protagonistë dhe dëshmitarë të mjaft situatave tërheqëse dhe rrëqethëse në roman, sidomos me lidhjet që vijjnë nga praktika e farmologjisë. Një lidhje paralele udhëton në kohë dhe hapësirë për të ndërtuar mesazhin. Herë në këtë lidhje gjen hapësirë studentore, herë intelektin e ndrydhur të kohës, herë artin e diktuar e të transformuar, herë diktatin e një shqërie që më së shumti rrëkon mbi plagë femërore të pafajshme, herë bojën dhe lojën e së vjetërs me të rene, që nxjerr inatin duke zarfuar edhe 'një palë mbathje vishnje të errët' të përfunduara deri në sektorin e Kulturës në Kryeministri. Një lidhje kjo që sa inatçore, hakmarrëse dhe poshtërruese për vajzën e titullarit të lartë zyrtar, shton edhe kërshërinë për të lexuar me nge faqet e romanit. Më pas klinika e kafshëve të vogla të fakultetit të Veterinarisë ngrihet në roman si një paralele me morgun që Marenglen (Marenglen: shkurtimi i emrave Marks, Engels dhe Lenin) Qani Qeni kishte në patronazh. Është kjo lidhje morg-përgjegjës që del me nuancë të errëta në "Kloroform". Është pikërisht ajo që Charles J. Stivata e quan "vrimat e zeza" ("black holes") duke analizuar mendimin filozofik rreth zbrazëtisë dhe errësirës së prodhuar nga filozofët Deleuze dhe Guattari. Një njeje morali në këto dialogje është edhe fati i Ariana Gurit, studentes që u soll 'kartë postale' me një fëmijë me ngjyrë në çantë, duke murrosur dhe fundosur fatin dhe lirinë e nënës beqare, një gjendje e pamundur në regjimin totalitar. Dhe Ariana si mjaft karaktere të tjera s'kishte gjetur melhem

tjetër përveç morfinës. Por, një lloj 'morfinë' tjetër shfaqet në roman me prezencën e artit të dyzuar, muzikës, Lidhjes së Shkrimtarëve që kërkonin të krijohej për Partinë, dhe identitetit që kishin dashur t'i impononin Alma Fishtës: "Luiza Kodra, datëlindja 31 Janar 1959, Vendlindja Kir, Mirditë, Ndërprerja e barrës, motiv psikologjik".

Udhëtimi mes ngjarjeve si arsye

Udhëtimi në "Kloroform" mbetet një arsye. Një arsye që prodhon të fshehtë. Të fshehtë e mohuar. Të mohuarën e haruar. Tërë këtë udhëtesë drithëruese që mbetet mes fletësh të kësaj vepre letrare. Tërë këtë art që na mbetet në memorie. Një mbetje që lë gjurmë për të djeshmen, për të fotografuar të tashmen e për të kompozuar të ardhmen. Një imajinatë që në këtë udhëtim trefish kërkon detajin e fatit të jetës. Të jetës femërore që prodhon jetën. Jetën që dikur vritej në identitet të remë. Identitete kartelash...në këtë jetë plot fakte që freskohen nga një stil i qëlluar letrar e që na rishqillojnë kompleksin e fabulës. Diku shohim dhe ndjejmë para syve edhe jashtë gjermave, jashtë gjuhës së bukur e intelektuale të autores tërë këtë angazhim letrar. Një angazhim që mjafton të thuhet edhe kaq: Kartela vrastare, që kundërshtohet nga Alma, robdëshambri i klinikës, Zoti si një arsye që shton më tej dualizmin e shtetit laik dhe njerëzve të privuar nga drejta e besimit, barra, gruaja që shpurri 'brekët deri në Qeveri', rishfaqja e Qanos, kloroformi me erën e fortë të tij, kirurgu dhe loja e ndryrë e tij me gishtat, mesnata e tmershme, dhe... "Në emër të Popullit jeni e arrestuar!". Lehja e qenve, më pas dhe goditja e çiftes si një refren i përnatshëm, zbulon atë krahasim të bukur e tronditës që lidh turmat e qenve, që turen mbi trupa të pavarrosur, me fatin e përcjellë nga grata rome që diktojnë vëmendje tjetër në pak fraza domethënëse për fatin e keqtrajtuar të lirisë së femrës. Duke u shfaqur me postulatit e mirëgjetur "mëmësia, realiteti i vetëm që i shpëton diktaturës" ajo provon ikjen nga ajo klinikë tronditëse dhe me fjalinë shumë domethënëse: "[qentë] ato qenie të mjerat të lëna në meshirën e fatit nuk mund të depërtonin me dhëmbët e tyre aq thellë sa bisturitë e krimin...". ajo transformon krimin e penetruar në dikasteret ministrore që puqen në perspektivë.

Një stil letrar që i përshtatet subjektit

Autorja perdor dhe zhvillon formën narrative "stream of consciousness", por kjo formë narrative ndërhyrë jo vetëm, siç përdoret tradicionalisht për të shprehur monologun e brendshëm, por edhe për të shprehur atë pjesë që i mungon dialogut e që ngelet në stadin e të menduarit, nuk arin të materializohet në fjalë, pasi autoçensurohet. Kështu përmes kësaj procedeeje skaliten mrekullisht individuale të ndalur që mbijetojnë vetem duke u marrë vesh mes rrjeshtash... Kështu behet evident terrori që shtyp e shkatëron lirine e shprehjes. Eshte nje forme narrative ne adekuacion te plote me atmosferen e diktatures... Autorja nuk merr përsipër të konsiderojë një prozë për të shfaqur tiparet e karakteret e feminizmit, as edhe të asfiksojë fatin e femrës në totalitarizëm, por në mënyrë artistike na sjell një roman që qartëson faktin se komunizmi ishte një përgjigje e humbjes së moralit të humbur të tij. Ajo na përcjell mesazhin e qartë përmes një fabule prekëse duke bërë detyrën e shkrimtares, dhe proza e saj e rrjedhshme vjen duke udhërrëfyer qetësisht dhe me mirësjellje lexuesin të bëjë detyrën e tij imediate.